

**ÇELO HOXHA****VËSHTRIM MBI LEGJITIMITETIN E KONGRESIT  
TË PËRMETIT**

Në shumë libra historie, botuar gjatë regjimit komunist (1944-1991) ose pas rënies së tij, organizimi i Kongresit të Përmetit, 24 maj 1944, është trajtuar si një burim legjitimiteti për institucionet që dolën prej tij ose ishin krijuar para tij, ndërsa legjitimiteti i vetë Kongresit buron, bazuar në pretendimet e organizatorëve dhe narrativën historike, nga “zgjedhjet demokratike”. Për autorin e librit *Revolucioni Popullor në Shqipëri dhe Çështja e Pushtetit* (1977), Kongresi i Përmetit ishte “një përfaqësi e zgjedhur demokratikisht brenda mundësive që lejonin rrethanat e luftës”, i cili vendosi “ndërtimin e Shqipërisë së re Demokratike popullore sipas vullnetit të popullit”.<sup>1</sup> Në librin *Historia e Partisë së Punës së Shqipërisë* (1981) thuhet se Kongresi u thirr për “ligjësimin e pushtetit të këshillave nacionalçlirimtarë”.<sup>2</sup> Nga libri *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar, vëll. 4* (1989) rezulton që kongresi ka qenë “një kuvend i madh popullor”, i cili “do të kishte karakter kushtetues”.<sup>3</sup> Sipas librit *Historia e Popullit Shqiptar, vëll. 4* (2008), Kongresi i Përmetit ishte “një kongres demokratik”, i ngjashëm “me mbledhje të tilla [që] në këtë kohë po zhvilloheshin dhe në vende të tjera, në të cilat forcat demokratike

<sup>1</sup> Luan Omari, *Revolucioni popullor në Shqipëri dhe çështja e pushtetit*, UT, Fakulteti Juridik, Tiranë: 1977, f. 69.

<sup>2</sup> *Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë*, Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste, Tiranë: 1981, f. 152.

<sup>3</sup> *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar, vëll. 4*, Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste, Tiranë: 1989, f. 10. Shënim: Kushtetueshmëria e një veprimi ose ngjarjeje më së pari kërkon ekzistencën e një kushtetute në përputhje ose jo me të cilën veprimi duhet të kryhet ose ngjarja të ndodhë, ndërsa komunistët, duke mos e njohur kushtetutën e Mbretërisë Shqiptare, nuk vepronin sipas ndonjë kornize kushtetuese. Sidoqoftë, përdorimi i termit nga historianët nënkupton rëndësinë që ata i kanë kushtuar legjitimitetit të kongresit.

ligjësonin ndryshimet e ndodhura deri atëherë në sajë të luftës kundër agresorëve nazifashistë.”<sup>4</sup>

Legjitimiteti ka një tërësi kuptimesh, si koncept juridik, sociologjik, dhe moral.<sup>5</sup> Sipas sociologut të famshëm Max Weber, përkufizimit të të cilit i referohen shumë studiuesit, legjitimiteti mund të ketë disa burime: traditën, besimin, miratimin. Sipas traditës, e vlefshme është ajo që ka qenë gjithmonë e tillë; sipas besimit, ajo që është e dërguar, tipike, absolute. Ndërsa legjitimiteti i miratuar është një normë shoqërore “që buron nga një marrëveshje e vullnetshme e palëve pjesëmarrëse.”<sup>6</sup>

Legjitimiteti i Kongresit të Përmetit, burim i të cilit konsiderohen zgjedhjet dhe që është objekti i trajtimit të këtij artikulli, konsiderohet legjitimitet me miratim. Në rastin e Kongresit, palët që duan të bëjnë marrëveshje janë Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar (KPNÇ), i cili dëshironte mbajtjen e Kongresit, dhe populli, sepse vendimet e Kongresit do të ndikonin në jetën e tij. Marrëveshja e vullnetshme do të realizohej, nëse realizohej, përmes zgjedhjeve.

Ky artikull trajton pikërisht mënyrën e zhvillimit të zgjedhjeve, nëse u zhvilluan, dhe, meqenëse kongresi u mbajt, përfaqësimin e delegatëve për të kuptuar sa ishte i përfaqësuar vullneti i popullit.

### **Cili organ e mori vendimin për thirrjen e Kongresit të Përmetit?**

Përcaktimi se cili organ e mori vendimin për thirrjen e Kongresit të Përmetit, duke lexuar tekstet zyrtare të historisë, para dhe pas rënies së komunizmit, është çorientues. Sipas një burimi, vendimin e mori Kryesia e KPNÇ, me propozim të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Shqiptare (KQ i PKSH).<sup>7</sup> Dy burime të tjera pretendojnë pak a shumë të

<sup>4</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, grup autorësh, vëll. IV, *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj*, Tiranë: Toena, 2008, f. 97.

<sup>5</sup> Richard H. Fallon, Jr., *Legitimacy and the Constitution*, Harvard Law Review, Vol. 118, No. 6 (Apr., 2005), pp. 1794-1801.

<sup>6</sup> Max Weber, *Economy and Society* (Editor: Guenther Roth, Claus Wittich; Translated: Ephraim Fischoff, Hans Gerth, et al), University of California Press, 1987, f. 35.

<sup>7</sup> *Historia e Shqipërisë*, vëll. II, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë: 1965, f. 779.

njëjtën gjë: vendimin e mori KQ i PKSH me propozim të KPNC<sup>8</sup> dhe, dy, vendimi ishte iniciativë e KQ të PKSH, pa e përmendur fare rolin e KPNC.<sup>9</sup> Sipas një burimi të katërt, ideatori dhe propozuesi i thirrjes së kongresit ishte Enver Hoxha: ai e kishte bërë propozimin në KQ të PKSH dhe pastaj në KPNC.<sup>10</sup> Në tekstet e përgatitura pas rënies së regjimit komunist (1991), ekzistojnë, të paktën, dy versione. Në versionin e parë vendimin për thirrjen e kongresit e ka marrë kryesia e KPNC,<sup>11</sup> duke mos u përmendur fare roli i PKSH në këtë çështje, ndërsa sipas variantit të dytë vendimin e ka marrë kryesia e Komitetit Antifashist Nacional-çlirimtar.<sup>12</sup> Vetë Enver Hoxha, në Plenumin e Beratit, më 25 nëntor 1944, tha se Plenumi i Helmësit (15 maj 1944) “u bë që shokët [e PKSH] të aprovonin Kongresin e Përmetit.”<sup>13</sup>

Vendimin formal për mbajtjen e Kongresit të Përmetit e mori Kryesia e KPNC, e cila u mbledh në Helmës të Skraparit, më 15 prill 1944. Në rendin e ditës së mbledhjes ishin tre çështje për diskutim: 1. Gjendja politike e jashtme dhe e brendshme; 2. Gjendja ushtarake e ushtrisë partizane; dhe, 3. Diskutimi për mbajtjen e kongresit dhe qeverisë që do të dilte nga ai kongres. Në procesverbalin e mbledhjes, çështja e tretë është shënuar shkurt: “Kongresi dhe Qeveria.”<sup>14</sup>

<sup>8</sup> *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë: 1985, f. 512.

<sup>9</sup> Luan Omari, *Revolucioni popullor në Shqipëri dhe çështja e pushtetit*, Tiranë: UT, Fakulteti Juridik, 1977, f. 69.

<sup>10</sup> *Historia e Luftës Antifashiste ...*, f. 10.

<sup>11</sup> *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. IV, f. 96.

<sup>12</sup> Komiteti ANÇ ishte qeveria provizore që doli nga Kongresi i Përmetit, i cili nuk ekzistonte në kohën e vendimmarrjes për mbajtjen e Kongresit. Ky mund të konsiderohet një gabim, ngatërrim emrash, por duke pasur parasysh që është bërë në një botim serioz, nga Akademia e Shkencave, vlen të vihet në dukje (*Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, vëll. 2, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2008, f. 1259).

<sup>13</sup> *Politika antikombëtare e Enver Hoxhës: Plenumi i 2-të i KQ të PKSh, Berat, 23-27 nëntor 1944 (dokumente)*, përgatitën për botim Ndreçi Plasari, Luan Malltezi, Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë: Euroirilindja, 1995, f. 160. Diskutim i Enver Hoxhës në Plenumin e Beratit, 25 nëntor 1944.

<sup>14</sup> *Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSh*), Fondi (më tej: F.) 14, viti (më tej: V.) 1944, dosja (më tej: D.) 30, fl. 1. Procesverbal i mbledhjes së Kryesisë së KPNC.

Në fund, mbledhja doli me një vendim, i pasqyruar në rezolucion: “Të thirret një kongres nacional me emrin “Kongresi Antifashist Nacionalçlirimtar”, prej të cilit do të dalë “Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar” dhe “Të ngarkohet në mënyrë të veçantë seksioni organizativ i kryesisë që të marrë masat e duhura për mobilizimin e gjithë frontit nacional-çlirimtar, të këshillave, të Partisë Komuniste Shqiptare, të Ushtrisë PVNÇ, të Bashkimit të Rinisë Antifashiste Popullore, të Bashkimit të Gruas Antifashiste, të gjithë popullit, për një fushatë elektorale të gjerë dhe për organizimin e Kongresit.”<sup>15</sup>

Tekstet historike të përmendur më sipër, që ia japin PKSHE-së të drejtën e vendimmarrjes për thirrjen e Kongresit të Përmetit, janë botuar në periudhën kur PKSHE ishte në pushtet dhe ajo ushtronte kontroll të rreptë mbi botimet. Megjithatë, ky transferim të drejte nuk përbën devijim substancial nga e vërteta, sepse KPNÇ dhe KQ i PKSHE ishin thujse e njëjta gjë. Në shumë dokumente vihet re që këto dy organizma dublojnë rolet e njëra-tjetrës. Në formulimin e vendimit të KPNÇ duket qartë që PKSHE dhe strukturat politike brenda saj si Bashkimi i Rinisë, Bashkimi i Gruas, trajtoheshin si struktura në varësi të KPNÇ. Më 16 prill, Enver Hoxha u shkroi “gjithë komiteteve qarkore të Partisë Komuniste Shqiptare”,<sup>16</sup> për t’i vënë në dijeni degët lokale të partisë se paraqitej “e nevojshme dhe urgjente mbledhja e kongresit antifashist nacionalçlirimtar, kongres ku të dërgohen përfaqësuesat e vërtetë të popullit në luftë kundër fashizmit.”<sup>17</sup> Ai u tregonte atyre se vendimi ishte marrë nga kryesia e KPNÇ. Qarkorja udhëzonte gjithashtu që të angazhoheshin gjithë “shokët” e partisë për të siguruar suksesin “e plotë” të kongresit, për të zgjedhur “delegatë të provuar në luftë, në radhë të

<sup>15</sup> *Po aty*, fl. 18, Rezolucioni i mbledhjes së kryesisë së KPNÇ, 15 prill 1944.

<sup>16</sup> *Po aty*, F. 14, V. 1944, D. 74, fl. 6, Letër e KQ të PKSHE për gjithë komitetet qarkore të PKSHE, 16 prill 1944. Letra është firmosur nga Enver Hoxha, në emër të KQ.

<sup>17</sup> Termi fashist dhe antifashist në këtë periudhë tingëllon abuziv, sepse fashizmi ishte i lidhur vetëm me pushtimin italian dhe Italia kishte 9 muaj që kishte deklaruar kapitullimin. Fashizmi si ideologji dhe forcë ushtarake kishte dalë nga loja, por i vetmi shpjegim pse komunistët mund ta kenë përdorur është për shkak se termi fashist ishte më motivues për njerëzit, sesa nazizmi. Ushtria gjermane kishte shumë pak kohë në Shqipëri, dihej që ishte kalimtare dhe kishte marrë rrokullimën, kur komunistët vendosën t’i ndërronin emrin KPNÇ në Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar, gjë që ndodhi në Kongresin e Përmetit.

parë anëtarë të partisë, sipantizantë dhe miq të luftës”.<sup>18</sup> Po atë ditë, Omer Nishani, në emër të KPNÇ, urdhëroi KQ të BRASH të niste punën për fushatën elektorale që do të zgjidhte delegatët e kongresit.<sup>19</sup> KQ i PKSH dhe KPNÇ ishin aq të shkrirë me njëri-tjetrin sa në dy letra të veçanta ato kanë përdorur terminologji identike në përcjelljen e mesazheve. “*Të derdhet nga ana e shokëve një aktivitet i jashtëzakonshëm si nga partia ashtu dhe nga organizata e rinisë komuniste,*”<sup>20</sup> shkroi Hoxha në emër të KQ të PKSH; “Urdhërojmë Komitetin Qendror të BRASH që t’u japë direktiva të gjithë organizatave të rinisë *të derdhin krejt aktivitetin e tyre,*”<sup>21</sup> shkroi Omer Nishani, në emër të Kryesisë së KPNÇ. Njësimi i veprimtarisë së këtyre dy organizmave ishte aq i madh sa mund të thuhet me siguri që PKSH dhe KPNÇ ishin e njëjta gjë. Megjithatë, nëse do t’i trajtojmë të ndara këto dy organizma, e drejta e marrjes së vendimit i takon t’i njihet palës që dominonte tjetrën.

### **A u zhvilluan zgjedhje?**

Versioni dominues i narrativës historike të periudhës së komunizmit është që delegatët e Kongresit të Përmetit u përcaktuan me zgjedhje, të cilat u zhilluan, për shkak të luftës, të hapura. Në rezolucionin e 15 prillit, zgjedhjet e hapura quheshin “udhë demokratike indirekte.”<sup>22</sup>

Në zonat e pushtuara nga armiku delegatët do të caktoheshin nga këshillat nacional-çlirimtare.<sup>23</sup> Ky version është riprodhuar dhe në tesktet e botuara pas rënies së komunizmit,<sup>24</sup> dhe përputhet me rezolucionin e

<sup>18</sup> *Po aty*, F. 14, V. 1944, D. 74, fl. 6, Letër e KQ të PKSH për gjithë komitetet qarkore të PKSH, 16 prill 1944. Letra është firmosur nga Enver Hoxha, në emër të KQ.

<sup>19</sup> *Po aty*, F. 40, V. 1944, D. 11, fl. 6, Letër e kryesisës së KPNÇ për KQ të BRASH, 16 prill 1944. Letra mban firmën e Omer Nishanit, në emër të kryesisës.

<sup>20</sup> *Po aty*, F. 14, V. 1944, D. 74, fl. 6, Letër e KQ të PKSH për gjithë komitetet qarkore të PKSH, 16 prill 1944. Letra është firmosur nga Enver Hoxha, në emër të KQ.

<sup>21</sup> *Po aty*, F. 40, V. 1944, D. 11, fl. 6, Letër e kryesisës së KPNÇ për KQ të BRASH, 16 prill 1944. Letra mban firmën e Omer Nishanit, në emër të kryesisës.

<sup>22</sup> *Po aty*, F. 40, V. 1944, D. 30, fl. 15, 18, Rezolucioni i mbledhjes së kryesisës së KPNÇ, 15 prill 1944.

<sup>23</sup> *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ...*, f. 13.

<sup>24</sup> *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll. IV, f. 97.

mbledhjes së kryesisë së KANÇ, 15 prill 1944. Sipas rezolucionit, në kongres do të përfaqësoheshin zonat e lira, zonat e pushtuara, brigadat dhe batalionet e UNÇ, si dhe BRASH e BGASH që përfaqësoheshin me delegacione të veçantë. Në zonat e pushtuara nga armiku zgjedhjet nuk mund të zhvilloheshin “lirisht” prandaj delegatët e kongresit caktoheshin nga këshilli nacionalçlirimtar i qarkut ose, aty ku s’kishte këshill qarku, nga këshilli i qytetit që ishte qendër e qarkut. Në zonat e lira, delegatët do të zgjidheshin me votim të hapur: pjesëmarrësit në votime, të grumbulluar në një shesh, do të votonin duke ngritur dorën.

Procesi i zgjedhjeve kishte dy faza. Në fillim do të zgjidheshin delegatët e parë, me bazë elektorale komunën; populli i çdo komune mund të zgjidhte 3-5 delegatë. Delegatët e dytë ishin delegatët e kongresit, ata kishin bazë elektorale nënprefekturën; ata nuk zgjidheshin nga populli, por nga delegatët e komunave për çdo nënprefekturë. Delegatët e ushtrisë zgjidheshin nga mbledhjet e brigadave. Numri i delegatëve në kongres, për çdo nënprefekturë apo brigadë, përcaktohej nga KPNC, “në bazë të popullsisë dhe aktivitetit që kanë treguar në luftë.” BRASH do të kishte 10 dhe BGASH, 5 delegatë.<sup>25</sup>

Po a u zhvilluan realisht zgjedhjet?

Duke parë realitetin nga e njëjta frëngji me komunistët e 1944-ës, Shqipëria e Mesme dhe Shqipëria e Veriut ishin të pushtuara, kështu që ato nuk plotësonin kushtin numër një për zhvillimin e tyre: të qenit të çliruara. Vija ndarëse e tyre me jugun merrej lumi Shkumbin,<sup>26</sup> dhe në këtë pjesë të vendit supozohej që ekzistonin zonat e lira ku do të zhvilloheshin zgjedhjet.

Le të shikojmë sa zona të lira dhe sa të pushtuara kishte poshtë Shkumbinit në periudhën 15 prill-24 maj 1944, duke verifikuar datat që vetë PKSH i kishte pranuar si data çlirimi për secilin qytet dhe, aty ku është e mundur, dhe për ndonjë fshat. Po e nisim nga jugu duke u ngjitur drejt Shkumbinit. Gjirokastra konsiderohej (e vazhdon të konsiderohet) e çliruara më 18 shtator 1944;<sup>27</sup> Saranda më 10 tetor 1944;<sup>28</sup> Delvina një

<sup>25</sup> *AQSH*, F. 40, V. 1944, D. 30, fl. 15, Rezolucioni i mbledhjes së kryesisë së KPNC, 15 prill 1945.

<sup>26</sup> *Po aty*, fl. 99. Lexo gjithashtu urdhrin e SHP të UNÇ për Shtabin e Divizionit I, 1 qershor 1944: *po aty*, F. 41, V. 1944, D. 53, fl. 19-20.

<sup>27</sup> *Historia e Luftës Antifashiste ...*, f. 973.

<sup>28</sup> *Fjalori Enciklopedik Shqiptar ...*, f. 847.

ditë më pas;<sup>29</sup> Konispoli, skaji më jugor i Shqipërisë, më 28 gusht 1944;<sup>30</sup> Erseka më 20 tetor 1944;<sup>31</sup> Korça më 24 tetor 1944;<sup>32</sup> Bilishti në një ditë me Korçën;<sup>33</sup> Pogradeci më 30 gusht 1944;<sup>34</sup> Librazhdi më 10 nëntor 1944;<sup>35</sup> Gramshi më 10 korrik 1944;<sup>36</sup> Berati më 13 shtator 1944;<sup>37</sup> Kuçova më 18 tetor 1944;<sup>38</sup> Fieri më 15 tetor 1944;<sup>39</sup> Lushnja në një ditë me Kuçovën;<sup>40</sup> Vlora në të njëjtën ditë me Fierin;<sup>41</sup> Selenica më 20 tetor 1944;<sup>42</sup> Elbasani më 11 nëntor 1944.<sup>43</sup> Siç shihet, të gjitha këto qytete, pjesa dërrmuese e qyteteve të Shqipërisë poshtë apo afër Shkumbinit, në periudhën që nga marrja e vendimit për thirrjen e kongresit deri në mbajtjen e tij, rezulton të kenë qenë të pushtuara.

Nga qytetet poshtë Shkumbinit rezulton se kanë qenë “të çliruara” Çorovoda (1942),<sup>44</sup> Tepelena (1943),<sup>45</sup> Himara (1943)<sup>46</sup> dhe Përmeti (1943).<sup>47</sup> Interesante është të vërejmë që Tepelena dhe Përmeti ishin çliruar respektivisht më 13 dhe 15 shtator 1943, kur ushtria italiane kishte kapitulluar dhe ajo gjermane s’e kishte marrë ende kontrollin e Shqipërisë. Nëse pranohet që ato janë çliruar realisht në ato data, atëherë ushtria gjermane, që u largua nga Shqipëria në fund të nëntorit 1944, nuk i shkeli kurrë këto qytete, gjatë një viti e dy muaj që ndenji në Shqipëri. Në rastin e Himarës gjendja paraqitet e tillë: Borshi pretendohet të jetë

<sup>29</sup> *Po aty*, f. 176.

<sup>30</sup> *Po aty*, f. 522.

<sup>31</sup> *Po aty*, f. 243.

<sup>32</sup> *Po aty*, f. 529.

<sup>33</sup> *Po aty*, f. 96.

<sup>34</sup> *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ...*, f. 972.

<sup>35</sup> *Fjalori Enciklopedik Shqiptar ...*, f. 617.

<sup>36</sup> *Po aty*, f. 318.

<sup>37</sup> *Po aty*, f. 84.

<sup>38</sup> *Po aty*, f. 900.

<sup>39</sup> *Po aty*, f. 264.

<sup>40</sup> *Po aty*, f. 652.

<sup>41</sup> *Po aty*, f. 1170.

<sup>42</sup> *Po aty*, f. 951.

<sup>43</sup> *Po aty*, f. 232.

<sup>44</sup> *Po aty*, f. 162.

<sup>45</sup> *Po aty*, f. 1084.

<sup>46</sup> *Po aty*, f. 373.

<sup>47</sup> *Po aty*, f. 829.

çliruar në shtator 1944,<sup>48</sup> Dhërmiu në korrik 1944,<sup>49</sup> kurse Himara që ndodhet në mes të këtyre dy fshatrave, pak kilometra larg secilit, dhe lokalitet më i rëndësishëm se ato, më 17 korrik 1943. Vunoi, një fshat në mesin e rrugës Himarë-Dhërmi, “u dogj në qershor 1944 nga ushtria gjermane”.<sup>50</sup> Edhe duke e marrë të mirëqenë këtë çlirim të Himarës, me gjermanët kaq pranë, e bllokuar prej tyre nga të gjitha krahët, nuk kishte mundësi të organizoheshin zgjedhje elektorale apo mitingje publike për zgjedhjen e delegatëve të kongresit. Megjithatë, ajo që ka më shumë rëndësi është panorama e përgjithshme: Me Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut të pushtuar e të pranuar nga vetë komunistët, dhe me Shqipërinë e Jugut të vërtetuar se, në kohën e Kongresit të Përmetit, ka qenë e pushtuar, pretendimi i zhvillimit të zgjedhjeve elektorale për delegatët e Kongresit të Përmetit nuk përputhet me realitetin.

Në zonat e pushtuara, ku zgjedhjet nuk mund të bëheshin lirish, sipas vendimit të KPNÇ, delegatët do të caktoheshin (emëroheshin) nga këshillat nacionalçlirimtare të qarkut ose, kur s’kishte këshilla qarku, këshillat e qyteteve që ishin qendra qarqesh. Gjendja e këshillave, sipas referatit të Ramadan Çitaku në mbledhjen e 15 prillit në Helmës, ishte e tillë: në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut kishte këshilla nacionalçlirimtare vetëm në qytete, sepse këshillat e tjera – në fshatra, nën-prefektura – ishin shpërbërë. Për Pezën, bazë e njohur e komunistëve, Çitaku u shpreh: “Me ikjen e popullit këshillat nuk ekzistojnë më.”<sup>51</sup>

Gjendja në Shqipërinë e Jugut, e referuar nga Çitaku, nuk ndryshonte shumë nga Shqipëria e Mesme dhe e Veriut. Në Mallakastër këshillat ishin tërhequr bashkë me ushtrinë partizane, pa rezultat në punën e tyre. Kolonja ishte “me Ballin”, e për rrjedhojë s’kishte këshilla. Në Tepelenë, që komunistët e konsideronin të çliruar, “kishillat në fshatra të

<sup>48</sup> *Po aty*, f. 109. Interesant është fakti që në një dokument të Brigadës XII, 10 nëntor 1944, raportohet për luftime në hapësirën nga Shën Vasili në Sarandë, përgjatë gjithë bregut Borsh-Himarë-Dhërmi-Dukat. Armiku është tërhequr prej Borshit, thuhet në këtë dokument, ndërsa pozicionet tona janë të pandryshueshme, që do të thotë se partizanët nuk ishin futur ende në Borsh. Gjermanët qëndronin në pika strategjike: kalanë e Borshit, malin e Qeparoit dhe të Skutarit, ngjitur me Himarën. Shiko: *AQSH*, F. 41, V. 1944, D. 93, fl. 7, 11-14. Raport i Brigadës XII.

<sup>49</sup> *Fjalori Enciklopedik Shqiptar ...*, f. 222.

<sup>50</sup> *Po aty*, f. 1179.

<sup>51</sup> *AQSH*, F. 14, V. 1944, D. 30, fl. 7, Procesverbal i mbledhjes së Kryesisë së KPNÇ.

pakrijueme.” Në Kurvelesh, krahinë me 15 fshatra, popullsia po largohet dhe kjo e bënte të paefektshme ekzistencën e këshillave. Në zonën e Himarës – vetë qytetin komunistët e konsideronin të çliruar që më 1943 – s’kishte këshilla fare, për shkak të “reaksionit zervist”. Në Lushnjë e Fier këshillat i kishte shpërndarë “reaksioni”. Në Skrapar kishin këshilla në këto fshatra ose krahina: Tomoricë, Nahije, Sulovë. Në lidhje me Përmetin, zonë e konsideruar e çliruar që më 1943, Çitaku foli vetëm për “zonat e krishtera”, ku këshillat ishin të reja, jo “siç duhet demokratike”, sepse kjo zonë kishte “qenë me Ballin”.<sup>52</sup>

Mungesa e këshillave nacionalçlirimtare ose gjendja e dobët e tyre do të thoshte që komunistët nuk kishin kontrollin e atij qyteti, fshati apo krahine, pavarësisht se ajo mund të përfshihej në territor që komunistët e konsideronin të çliruar. Gjendja e këshillave, e përshkruar nga Ramadan Çitaku, tregon që komunistët nuk e kontrollonin nga ana administrative, Shqipërinë e Jugut.

Meqenëse Shqipëria e Jugut rezultoi, sipas historiografisë komuniste e paçliruar para 24 majit 1944, por dhe pse kontrolli i komunistëve mbi territoret të banuara në jug ka qenë sporadik, duke u bazuar në referatin për gjendjen e këshillave nacionalçlirimtare, duket që në atë pjesë të Shqipërisë s’ka pasur kushte për zhvillimin e zgjedhjeve elektorale. Për rrjedhojë, diskutimi në ish-in apo jo demokratike zgjedhjet, siç premtonte KPNC, nuk mund të bëhet. Megjithatë, vlen të kujtohet se porosia e PKSH ishte që, nëse do të bëheshin mitingje me popullin, në to të merrte pjesë dhe ushtria.<sup>53</sup> Votimi i hapur i popullit, i bërë në praninë e një mase njerëzish të armatosur, në shërbim të organizatorëve të zgjedhjeve, nuk mund të konsiderohej votim demokratik.

### **A ishte kombëtar Kongresi i Përmetit?**

Pavarësisht se nuk u zhvilluan zgjedhje, kongresi u mbajt. Duke iu referuar zonave, apo organizatave që delegatët përfaqësonin, bazuar në dokumentet e kongresit, mund të kuptojmë në u përmbush apo jo dimensionin kombëtar i tij, i theksuar nga KPNC.

<sup>52</sup> *Po aty*, fl. 7-9, Diskutim i Ramadan Çitakut për gjendjen e këshillave nacionalçlirimtare.

<sup>53</sup> *Po aty*, F. 14, V. 1944, D. 74, fl. 6, Letër e KQ të PKSH për gjithë komitetet qarkore të PKSH, 16 prill 1944. Letra është firmosur nga Enver Hoxha, në emër të KQ.

Kongresi i Përmetit i hapi punimet më 24 maj 1944. Në orën 10 hyri në sallë kryesia e KPNÇ, e shoqëruar me duartrokitje të shfrenuara. U këndua himni kombëtar dhe pastaj u bë apeli i delegatëve. U lexuan me zë të lartë gjithë emrat, përfshi ata të kryesisë, një për një.<sup>54</sup>

Në sallë ishin, së bashku me 18 anëtarë të kryesisë së KPNÇ, 187<sup>55</sup> delegatë, të ndarë sipas zonave, organizatave apo njësive ushtarake partizane që përfaqësonin. Grupet e përfaqësimit, veç kryesisë së KPNÇ, bazuar në terminologjinë e tekstit origjinal të daktilografuar, ishin: Terreni (për shembull, terreni i Korçës), Zonat (për shembull, zona e Korçës), Rinia Antifashiste, Gruaja Antifashiste dhe Brigadat (partizane). Kjo ndarje territoriale nuk përkon me ndarjen territoriale që përmendet në rezolucionin e mbledhjes së 15 prillit: komuna, nënprefektura, prefektura; ashtu siç kishte qenë e organizuar për një kohë të gjatë Shqipëria.

Përfaqësimi në numër delegatësh ishte: terreni i Korçës – 18 delegatë, zona e Korçës – 7; terreni i Gjirokatrës – 21, Zona I Operative Vlorë-Gjirokastër – 16, terreni i Vlorës – 11; terreni i Beratit – 10, zona e Beratit – 5; terreni i Elbasanit – 5, zona e Elbasanit – 3; terreni i Tiranës – 10, zona e Pezës – 3; terreni i Durrësit – 2; Rinia Antifashiste – 10; Gruaja Antifashiste – 5; UNÇ (Brigadat) – 43.<sup>56</sup>

Terreni do të thotë forcat territoriale të një qyteti të caktuar, të cilat ishin në shërbim të UNÇ, si furnitorë të saj me partizanë, por që kryenin dhe detyra të tjera. Ato ishin si një farë ushtrie rezervistësh që mund të thirreshin nën armë kurdo që e shihte të nevojshme SHP i UNÇ.<sup>57</sup> Këto njësi përfaqësoheshin, së bashku, me 77 delegatë. Duke bashkuar delegatët e zonave territoriale me ata të brigadave, UNÇ u përfaqësua me 120 delegatë. Por këta nuk ishin delegatët e vetëm të saj. Delegatët që konsideroheshin përfaqësues të zonave nuk ishin gjë tjetër veç njerëz të UNÇ. Për Zonën e Korçës, për shembull, lista e delegatëve përbëhej nga Teki Kolaneci,<sup>58</sup> kolonel i parë, komandant i Shtabit të qarkut Korçë; Riza Kodheli,<sup>59</sup> kolonel i parë, komandant batalioni; Hamdi Babani,<sup>60</sup>

<sup>54</sup> *Po aty*, F. 40, V. 1944, D. 13, fl. 1-2, Procesverbali i Kongresit të Përmetit.

<sup>55</sup> Disa burime e japin numrin e delegatëve 186 dhe disa rreth 200. Numri 187 është sipas numërimit të autorit të këtij punimi.

<sup>56</sup> *Po aty*, F. 40, V. 1944, D. 13, fl. 1-2, Procesverbali i Kongresit të Përmetit.

<sup>57</sup> *Fjalori Enciklopedik Shqiptar ...*, f. 75.

<sup>58</sup> *AQSH*, F. 41, V. 1944, D. 123, fl. 1, Propozime të KANÇ për gradime.

<sup>59</sup> *Po aty*, fl. 1.

<sup>60</sup> *Po aty*, fl. 3.

toger, zëvendëskomandant batalioni territorial, etj. Lista e zonës së Beratit kryesohej nga dy ushtarakë partizanë të njohur: Mestan Ujaniku, major, komandant i Shtabit të qarkut të Beratit,<sup>61</sup> dhe Kahreman Ylli, komisar i Brigadës IV.<sup>62</sup> Lista e Tiranës kryesohej nga Abdyl Këllezi, komisar i Brigadës XVI.<sup>63</sup> Zona e Pezës kryesohej nga Kristo Themelko, komisar i Çetës së Pezës.<sup>64</sup> Pjesa dërrmuese e delegatëve të rinisë dhe gruas antifashiste – personazhe shumë të njohur pas lufte, ishin partizanë, ose të lidhur me ushtrinë partizane në një farë mënyre. Por dhe delegatët më pak të njohur, gjasat janë të kenë qenë partizanë, megjithëse substanca e kongresit nuk varej nga roli i tyre.

Pretendimi<sup>65</sup> se në kongres morën pjesë delegatët “nacionalistë” dhe “demokratë” si Shefqet Beja, Kol Kuqali, Gjergj Kokoshi dhe Riza Dani nuk mbështetet nga dokumentet e Kongresit. Ata mungojnë në listën e pjesëmarrësve, mungojnë në listën e diskutantëve, dhe, më e rëndësishmja, dhe sikur të merrnin pjesë, roli i tyre nuk do të kishte ndonjë ndikim. Riza Dani dhe Gjergj Kokoshi u zgjodhën anëtarë të KANÇ-it, por mund të jenë zgjedhur në mungesë siç u zgjodh Baba Faja, Haki Stërmilli dhe Ollga Plumbi, të cilët nuk morën pjesë; Faja dhe Stërmilli nuk udhëtuan drejt Përmetit nga frika e forcave “reaksionare”,<sup>66</sup> Plumbi ngaqë ishte e sëmurë.<sup>67</sup> Sidoqoftë, ndikimi i këtyre personave në PKSHP ishte ky: kur udhëheqja e saj deshi t’i hiqte qafe, megjithëse ata kishin pushtet në nivel deputeti, i hoqi me lehtësinë më të madhe.<sup>68</sup>

<sup>61</sup> *Po aty*, fl. 1.

<sup>62</sup> *Po aty*, F. 41, V. 1944, D. 94, fl. 8, Raport për SHP të UNÇ.

<sup>63</sup> *Po aty*, F. 41, V. 1944, D. 96, fl. 4, Letër e Brigadës XVI për Brigadën VII.

<sup>64</sup> *Po aty*, F. 14, V. 1943, D. 24, fl. 27/1, Letër e Kristo Themelkos për Gogo Nushin.

<sup>65</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV, f. 97. Në tekst thuhet shprehimisht: “Në radhët e delegatëve kishte atdhetarë nga i gjithë vendi, ndër ta dhe nacionalistë të njohur demokratë, si Shefqet Beja, Kolë Kuqali, Gjergj Kokoshi, Riza Dani etj.” Përmendja specifike e këtyre personave i jep rolin të tyre një rëndësi të veçantë, gjë që realisht nuk e kanë pasur.

<sup>66</sup> *AQSH*, F. 40, V. 1944, D. 11, fl. 6, Letër drejtuar kryesisë së KPNC, 10 maj 1944. Ai shpjegon arsyet e mos pjesëmarrjes në kongres.

<sup>67</sup> *Po aty*, fl. 4, Letër e Ollga Plumbit për kryesinë e KPNC, 4 maj 1944. Ajo shpjegon se nuk mund të merrte pjesë në kongres për arsye shëndetësore.

<sup>68</sup> Riza Dani u dënua me vdekje më 22 janar 1948; Gjergj Kokoshi u dënua si anëtar i një organizate terroriste me 20 vjet burg më 1946 dhe vdiq në burgun e Burrelit

Përfaqësimi kombëtar në kongres ishte i kufizuar, dhe bazuar në listat përfaqësuese të organizatorëve. Pjesa e Shqipërisë nga Tirana deri në veri dhe verilindje, gjysma e Shqipërisë, nuk kishte asnjë delegat.<sup>69</sup> Nga Shqipëria e Mesme dhe e Jugut ishin përfaqësuar veç një numër i vogël qytetesh. Kavaja, Lushnja, Fieri, krahina e Kolonjës, Mallakastrës, Skraparit dhe Devollit nuk kishin delegatë, të paktën jo nominalisht, siç kishte, le të themi, një fshat i Tiranës, me këshill nacionalçlirimtar jo ekzistent, Peza. Me delegatë nuk ishin përfaqësuar as qytetet që pretendohesh se ishin të çliruara: Përmeti, Çorovoda, Tepelena dhe Himara. Megjithatë, edhe ato qytete që pretendohesh se ishin përfaqësuar, listat e tyre ishin mbushur me njerëz të ushtrisë partizane.

Arsyeja e këtij përfaqësimi ishte shtrirja e kufizuar e influencës së PKSH, KPNÇ dhe UNÇ. Një nga vperimet e para që bëri SHP i UNÇ pas Kongresit të Përmetit ishte nisja e ushtrisë për vendosjen nën kontroll të zonave që nuk ishin përfaqësuar në kongres. Dy ditë pas kongresit, SHP i UNÇ dha urdhër që Divizioni I të nisej drejt Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut. Mes detyrave të tij ishin a) ngritja dhe forcimi i pushtetit “nacional-çlirimtar” dhe rimëkëmbja e njërive partizane të shkrira “nga reaksioni” gjatë dimrit 1943-44.<sup>70</sup> Ky ishte dhe mesazhi përfundimtar i kongresit, i përcjellë si fjali e fundit e fjalimit përmbyllës të punimeve, i mbajtur nga Omer Nishani: “Jam i sigurt se Komiteti Antifashist Nacional-Çlirimtar, me anën e ushtrisë s’onë heroike do t’ia arrijë qëllimit të tij, që është vendosja e pushtetit.”<sup>71</sup>

Formalisht në Kongresin e Përmetit nuk pati delegacion të veçantë të KQ të PKSH, ndërsa strukturat vartëse të tij – BRASH dhe BAGSH – u përfaqësuan me delegatë, megjithëse PKSH punoi me përkushtim për organizimin e kongresit. As SHP i UNÇ, nuk mori pjesë me delegacion,

më 1950; Shefqet Beja u ekzekutua më 3 tetor 1947; Kol Kuqali vdiq nga torturat në hetuesi më 1947.

<sup>69</sup> Dedijer është i vetmi autor që thotë se në kongres kishte dhe delegatë nga Shkodra, por kjo nuk ka bazë dokumentare. Shih: Vladimir Dedijer, *Marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare*, Tiranë: Medaur, 2005, f. 97-99.

<sup>70</sup> *AQSH*, F. 41, V. 1944, D. 53, fl. 19-20, Urdhër i shtabit të UNÇ për shtabin e Divizionit I për kalimin në Shqipërinë e Mesme, 1 qershor 1944.

<sup>71</sup> *Po aty*, F. 40, V. 1944, D. 15, fl. 15, Fjala e mbajtur me rastin e mbylljes së Kongresit I Antifashist Nacionalçlirimtar prej Dr. Omer Nishanit, 28 maj 1944.

megjithëse pjesëmarrja e tij ishte përcaktuar automatike nga KPNÇ,<sup>72</sup> ndërkohë që salla e delegatëve ishte mbushur me partizanë të thjeshtë e drejtues të formacioneve partizane të ushtrisë që e drejtonte SHP. Shpjegimin për këtë e kemi cekur dhe më lart: Shtabi i Përgjithshëm i UNÇ, KPNÇ dhe KQ i PKSHE ishin e njëjta gjë, dhe nëse këto struktura do të përfaqësoheshin veç e veç, thjesht do të lexoheshin tre herë emrat e të njëjtëve persona. Dihet, që PKSHE vepronte në hije, duke u fshehur pas strukturave si Fronti Nacionalçlirimtar, Këshilli Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, Ushtria Nacionalçlirimtare, madje ajo e konsideroi veten në ilegalitet dhe në kohën që Shqipëria ishte, sipas pretendimeve të saj, e çliruar, në periudhën 1945-1948.

### Mungesa e kohezionit në narrativën historike

Narrativa historike e botimeve zyrtare, për organizimin e Kongresit të Përmetit, përfshi këtu botime të institucioneve shkencore më të larta, gjatë regjimit komunist ose pas rënies së tij, ka mospërputhje të dukshme në pasqyrimin e ngjarjeve të luftës. Këto mospërputhje gjenden brenda të njëjtij tekst, por edhe në dy tekste apo më shumë të botuara nga i njëjti institucion. Në librin *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar*, vëll. 4, ndërsa Shqipëria e Jugut konsiderohet e çliruar në kohën e Kongresit të Përmetit,<sup>73</sup> një numër i konsiderueshëm i datave të çlirimit të qyteteve më të rëndësishëm të këtij territori, po sipas këtij botimi, rezultojnë të jenë më të vonshme se data e përfundimit të Kongresit.<sup>74</sup> E njëjta kundërshti vihet re në botime të kryera dhe nga Akademia e Shkencave. Në librin *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. 4, çështja e zonave të lira trajtohet shkurt, duke thënë se “200 delegatët, që morën pjesë, u zgjodhën në zonat e lira me votim të hapur”,<sup>75</sup> pa e përcaktuar cilat ishin këto zona. Zonat e jugut, që mendohet se ishin të

<sup>72</sup> *Po aty*, F. 40, V. 1944, D. 30, fl. 16, Rezolucioni i mbledhjes së kryesisë së KPNÇ, 15 prill 1945.

<sup>73</sup> *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ...*, vëll. 4, f. 44-45. Sipas këtij libri, qytete dhe qarqe të pushtuara kishte vetëm në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut. Aty thuhet: “Delegatëve të qyteteve dhe qarqeve të pushtuara të Shqipërisë së Mesme e të Veriut u qe dashur të kapërcenin pengesa e vështirësi të shumta gjatë udhëtimit.”

<sup>74</sup> *Po aty*, f. 973-979.

<sup>75</sup> *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. IV, f. 97.

lira, rezultojnë të jenë çliruar, sipas botimeve të tjera nga i njëjti institucion, pas 28 majit 1944, dita e mbylljes së Kongresit të Përmetit.<sup>76</sup>

Kundërshtitë e shpeshta, që shfaqen në narrativën historike zyrtare për organizmin e Kongresit të Përmetit, nxjerrin në pah difektet e historisë së shkruar nën censurën e regjimit komunist, të cilat nuk janë riparuar. Kjo narrativë vazhdon të jetë dominuese në botime të institucioneve të larta shkencore, si Akademia e Shkencave, por, pas rënies së regjimit komunist, ajo është sfiduar nga botime alternative. Për rastin e Kongresit të Përmetit, historiania Ana Lalaj ka hedhur dritë në drejtimin e duhur me krahasimin që i bën Kongresit të Përmetit me mbledhjen e dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë, që u mbajt më 29 nëntor 1943, në Jajcë të Bosnjës.

Në librin e saj “Dosjet e luftës”, zonja Lalaj shkruan: “PKJ dhe PKSHP u përpoqën të kapnin pushtetin, pra të “zgjidhnin” formën e regjimit që në kohën e luftës dhe në një farë mënyre ia arritën qëllimit. Në Jugosllavi dhe në Shqipëri u zgjodhën komitetet analoge antifashiste me të gjitha atributet e një qeverie dhe iu ndalua si Mbretit Peter II, ashtu dhe Mbretit Zog të ktheheshin në atdheun e vet.”<sup>77</sup>

Ndikimi i Partisë Komuniste Jugosllave (PKJ) në themelimin e PKSHP dhe veprimtarinë e saj të mëvonshme, gjatë dhe pas luftës (deri më 1948), është i njohur. Shumë kohë pas prishjes me Jugosllavinë, Enver Hoxha e pohoi sërish faktin që lidhjet e komunistëve shqiptarë me ata jugosllavë kishin filluar në verën e vitit 1941.<sup>78</sup> Kongresi i Përmetit, i organizuar sipas modelit jugosllav, është rrjedhojë logjike e kësaj lidhjeje, ku pala jugosllave kishte rolin e udhërrëfyesit, me direktivat që u dërgonte herë pas here kreu i PKJ, Josif B. Tito. Edhe Kongresi i Përmetit duket se ka filluar të formohet si ide pas një mesazhi nga Tito.

Më 9 tetor 1943, në një letër drejtuar Miladin Popoviçit, i cili vepronte pranë PKSHP, Tito sugjeronte që komunistët shqiptarë të shikonin mundësinë e krijimit “të një qeverie popullore”. Sipas tij, Shqipëria e kishte të lehtë një gjë të tillë, ngaqë ajo nuk kishte një qeveri

<sup>76</sup> Datat e çlirimit i kam cituar më lart nga *Fjalori Enciklopedik Shqiptar* (1985), botim i Akademisë së Shkencave, por shumica e këtyre datave janë të njëjta dhe në *Fjalorin Enciklopedik Shqiptar*, i ribotuar me tre vëllime, nga i njëjti institucion, pas rënies së komunizmit.

<sup>77</sup> Ana Lalaj, *Dosjet e luftës*, Tiranë: Toena, 2014, f. 168-169.

<sup>78</sup> Enver Hoxha, *Titistët*, Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste, Tiranë: 1982, f. 3.

në mërgim të njohur nga aleatët, kurse jugosllavët i kishin “duart të lidhura” për shkak të ekzistencës së një qeverie të tillë, e cila, megjithëse nuk njihej nga komunistët jugosllavë, njihej nga aleatët ndërkombëtarë të tyre. Në atë letër, Tito tregonte gjithashtu që PKJ i kishte krijuar tashmë komitetet [qeveritë] në Slloveni dhe në Kroaci, ndërsa për gjithë Jugosllavinë ky komitet u krijua në mbledhjen e dytë të ANVOJ-it.<sup>79</sup>

Për ndikimin jugosllav në Kongresin e Përmetit flasin dhe disa detaje të vogla. Organi legjislativ që doli nga Kongresi u emërtua në mënyrë identike me organin legjislativ të komunistëve jugosllavë: Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar [Shqiptar, Jugosllav]. Qeveria u quajt komitet, edhe ky një emërtim i marrë nga letra e Titos. KANÇ-i ndaloi kthimin e mbretit Zog I në Shqipëri, ashtu si ANVOJ-i kishte ndaluar kthimin mbretit jugosllav në Jugosllavi.

### **Përfundime**

Bazuar në rezolucionin e mbledhjes së Kryesisë së KPNÇ, 15 prill 1944, legjitimiteti i Kongresit të Përmetit do të buronte nga zgjedhja demokratike e delegatëve dhe përfaqësimi kombëtar i tyre. Realizimi i zgjedhjeve “demokratike indirekte”, siç thuhej në rezolucion, kërkonte plotësimin e një kushti: ekzistencën e zonave të çliruara, të cilat, sipas të njëjtit dokument, ekzistonin. Në një zonë të çliruar populli mund të merrte pjesë lirisht në votime.

Bazuar në narrativën historike të shkruar gjatë regjimit komunist, por dhe më vonë, në Shqipërinë e Jugut, që KPNÇ e konsideronte zonë të çliruar, ajo nuk ishte e tillë. Datat e çlirimit të shumicës së qyteteve, të festuara për 45 vjet, në kalendar ishin më të vonshme se 28 maji, dita e fundit e Kongresit. Veç kësaj, dhe 3-4 qytete që rezultojnë të kenë datë çlirimi më të hershme se fillimi i Kongresit, ato nuk rezultojnë të kenë qenë – duke qenë dhe nënprefektura – të përfaqësuara me delegatë në Kongres. Kjo e bën të panevojshëm diskutimin për formën e zgjedhjeve, në ish-in demokratike apo jo.

Megjithatë, kongresi u mbajt dhe aty shkuan delegatë që përfaqësonin diçka ose dikë, por ky përfaqësim nuk ishte domosdoshmërisht kombëtar. Fakti që aty mund të ketë pasur “atdhetarë nga i gjithë vendi”<sup>80</sup> nuk tregon se përfaqësimi i tyre ishte kombëtar. Karakteri

<sup>79</sup> Ana Lalaj, *Dosjet e luftës ...*, f. 117.

<sup>80</sup> *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. IV, f. 97.

kombëtar i një organi politik do të thotë sot – e këtë kuptim kishte dhe atëherë – që ai të ketë garantuar shumicën e votave në zgjedhje ku votojnë gjithë qytetarët e Shqipërisë me të drejtë vote. Fakti që gjysma e vendit, ose një pjesë më e madhe, ishte e pushtuar, ishte arsye që Kongresi të mos mbahej, dhe jo që të gjendej një mënyrë alternative – delegatët e emëruar – për përfaqësimin. Karakteri kombëtar, dhe legjitimiteti, burojnë nga votimet me shtrirje kombëtare. Delegatët e emëruar përfaqësonin vullnetin e organit që i kishte emëruar dhe jo të popullit. Fakti që vendimmarrësit e mbajtjes së Kongresit e morën në konsideratë përfaqësimin e territoreve shqiptare që i konsideronin të pushtuara, tregon se ata ishin të vetëdijshëm për kuptimin e konceptit kombëtar dhe të ndjeshëm për përmbushjen e tij, por zgjodhën rrugën e gabuar, ose atë që u interesonte. Zgjedhja e përfaqësimit me emërim tregon që ata ishin të ndjeshëm për anën e jashtme të gjërave, jo përmbajtjen e tij.

Organizatorët e Kongresit ishin një grup njerëzish që kishin interesa të tjera nga masa e madhe e qytetarëve dhe nga nevojat që kishte vendi. Banorët e zonave që vetë komunistët i konsideronin të pushtuara, nuk mund të kishin shqetësim krijimin e një qeverie, por, më së pari, çlirimin e vendit, ose mbijetesën në kushtet e pushtimit. Në këtë pikë, Kongresi nuk ofroi atë çfarë pritej. Bazuar në narrativën historike zyrtare, se gjithë Shqipëria ishte pushtuar, është e logjikshme të thuhet që interesat e banorëve të saj nuk përputheshin me interesat e organizatorëve të Kongresit.

Me qeveri, drejtuesit komunistë nënkuptonin thjesht marrjen e pushtetit nga ana e tyre. Faktori i brendshëm për ta ishte i rëndësishëm vetëm në një pikë: forcimi i ushtrisë partizane. Dhe pikërisht ky faktor ishte përcaktues në faktin pse vendimi për mbajtjen e Kongresit u mor në prill, dhe jo më herët, kur u erdhi mesazhi nga Tito (tetor 43) për krijimin e një qeverie.

Gjatë dimrit 1943-44, ushtria partizane pësoi goditje të forta nga ushtria gjermane, disa brigada pothuasje u shpërbënë, por në javët e para të pranverës ajo nisi ta rimerrte veten dhe kjo shtonte sigurinë e KPNÇ për shpejtimin e qeverisë, ekzistenca e së cilës ishte domosdoshmëri e nxitur nga faktorë të jashtëm.

Arsyeja pse krijimi i qeverisë s’duhej vonuar, sipas Ymer Dishnicës, anëtar i KPNÇ, ishte bindja se “jemi përpara një zbarkimi” dhe fitoret e

“ushtërive të kuqe në Ballkan”.<sup>81</sup> Zbarkimi për të cilin fliste ai ndodhi pak ditë pas mbylljes së Kongresit të Përmetit, më 6 qershor 1944, në Francë. “E këtyre duhet t’u paraqitemi me një qeveri,” tha Dishnica, më 15 prill, i cili referoi “Mbi gjendjen politike të jashtme dhe të brendshme”.<sup>82</sup> Dishnica theksoi si faktor të brendshëm ndihmës faktin që Shqipëria nuk kishte qeveri në mërgim, argument i përmendur fillimisht nga Tito, dhe, sipas tij, Zogu nuk ishte përmendur “makar një herë as në radio [BBC].”<sup>83</sup>

I mbajtur pa zgjedhje, pa përfaqësim kombëtar, dhe duke mos përfaqësuar vullnetin e popullit shqiptar, Kongresi i Përmetit, prej të cilit dolën ligje dhe vendime që patën ndikim në jetën e vendit për gati gjysmë shekulli, ishte një organ pa legjitimitet, e të tilla ishin dhe organet që dolën prej tij.

Në kongres morën pjesë “në radhë të parë anëtarë të partisë, simpatizantë dhe miq të luftës [partizane],” pikërisht ashtu siç kishte dëshiruar dhe porositur PKS. Kongresi u kthye në një shfaqje propagandistike për pjesëtarët e UNÇ, drejtues e partizanë të thjeshtë, të cilët u prezantuan me shijen e privilegjeve që do të gëzonin, kur të merrnin pushtetin. Duke u bërë anëtarë të KANÇ, shumica e delegatëve e përfytyruan veten deputetë në organin ligjvënës. Ata që u emëruan anëtarë të Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar e panë veten ministra të qeverisë së ardhshme. Disa nga gratë e pranishme e shikonin veten bashkëshorte të njerëzve më të pushtetshëm në Shqipërinë e nesërme, gjë që ndodhi.<sup>84</sup> Dhe në masë dërrmuese, menjëherë pas kongresit, delegatët u graduan: gjeneralë, majorë, kapitenë, kolonelë, togerë, etj., përfshi dhe anëtarët e kryesisë së KANÇ-it, të qeverisë së përkohshme, apo anëtarë të thjeshtë të PKS. <sup>85</sup> Numri i gradimeve që u dhanë ishte afërsisht me

<sup>81</sup> *AQSH*, F. 40, V. 1944, D. 30, fl. 2, Procesverbal i mbledhjes së Kryesisë të KPNC, 15 prill 1944.

<sup>82</sup> *Po aty*.

<sup>83</sup> *Po aty*.

<sup>84</sup> Katër nga gratë delegate në Kongresin e Përmetit ishin lidhur tashmë ose u lidhën me njerëzit që kongresi u hapi rrugën drejt pushtetit: Nexhmije Xhuglini me Enver Hoxhën, Fiqrete Sanxhaktari me Mehmet Shehun, Vitori Kondi me Hysni Kapon dhe Liri Gega me Dali Ndreun.

<sup>85</sup> Dhënia e gradave ishte vendimi i katërt që mori KANÇ, në mbledhjen e tij të parë. Propozimin për gradat, sipas vendimit, e kishte bërë SHP i UNÇ. Grada

numrin e delegatëve që morën pjesë në kongres: 186.<sup>86</sup> Pasi u bënë një masë ushtarake solide dhe e motivuar – PKSH, KANÇ dhe UNÇ – u nisën drejt Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut me detyrën “për të vendosur aty pushtetin”<sup>87</sup> civil me metoda ushtarake.

### *S u m m a r y*

#### A CONSIDERATION ON THE LEGITIMACY OF THE CONGRESS OF PËRMET

The official historical narrative of Albanian communist regime has been (and is still being held by many historian and history texts) that its source of legitimacy was the so called First Antifascist National Liberation Congress, mostly known as Congress of Permet (24-28 May 1944), which established two important institutions: Antifascist National Liberation Council, as the legislative body, and Antifascist Committee, the executive one. Most of delegates of Congress, this narrative goes, were chosen through democratic election in the liberated zones and they were appointed in non-liberated ones. This article challenges this historical view, written under tight control of communist regime and in accordance with its political propaganda ends, and argues that Congress of Permet cannot be considered, judged exclusively by organizers standards of democratic election expressed in their documents, a democratically elected institution, because it did not meet even the most basic of conditions. This article finds that most of the pretended liberated zones were not as such at that time, but, and this is according to the very texts that hold this view, they were liberated a few months after the Congress. This article, however, analyses also the national representation of delegates present at the event, the mode of their selection, the cohesion of historical narrative, and concludes that Congress of Permet was a non democratic gathering of communists, partisans and other people affiliated to them, which laid foundations of their future grab of power.

---

morën dhe anëtarët e KANÇ dhe Komitetit ANÇ, duke e deklaruar hapur veten si struktura të UNÇ. Për vendimin shih: *AQSH*, F. 40, V. 1944, D. 18, fl. 3.

<sup>86</sup> Për gradimin shih: *Po aty*, F. 41, V. 1944, D. 123. Janë disa lista të gjata me gradime të bëra nga KANÇ.

<sup>87</sup> *Politika antikombëtare e Enver Hoxhës ...*, f. 161. Diskutim i Enver Hoxhës në Plenumin e Beratit, 25 nëntor 1944.